



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2024/0580

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), në bazë të nenit 105,106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (LPP), në përbërje nga Batisha Ibrahimimi, paneliste individuale, duke vendosur sipas ankesës me Nr. 2024/0580, e datës 01.07.2024 të parashtruar nga Operatorit Ekonomik Donjeta Gashi Hamzaj B.I., kundër vendimit për dhënie të kontratës, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Fushatë vetëdijesuese për riorganizimin e Arsimit në Kryeqytet” me nr. të prokurimit: "616-24-4754-2-2-1", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues – Kuvendi i Komunës së Prishtinës me datën 13.08.2024, mori këtë:

Vendim

1. Aprovohet, si e bazuar ankesa me nr. 2024/0580 e datës 01.07.2024 e Operatorit Ekonomik (OE) Donjeta Gashi Hamzaj B.I., kundër vendimit për dhënie të kontratës, lidhur me aktivitetin e prokurimit: “Fushatë vetëdijesuese për riorganizimin e Arsimit në Kryeqytet” me nr. të prokurimit: "616-24-4754-2-2-1", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues – Kuvendi i Komunës së Prishtinës.
2. Anulohet, Njoftimi mbi vendimin (B58) për dhënie të kontratës i AK-së, i datës 14.06.2024, lidhur me aktivitetin e prokurimit: “Fushatë vetëdijesuese për riorganizimin e Arsimit në Kryeqytet” me nr. të prokurimit: "616-24-4754-2-2-1", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues – Kuvendi i Komunës së Prishtinës ndërkaj aktiviteti i prokurimit të kthehet në Rivlerësim.
3. Autoriteti kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.
4. Në përputhje me Rregulloren e Punës së OSHP-së, operatorit ekonomik Donjeta Gashi Hamzaj B.I., i kthehet tarifa e ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale –

Me 17.05.2024, Kuvendi i Komunës së Prishtinës në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar Njoftimin për Kontratë B05 lidhur me aktivitetin e prokurimit.

Ndërsa me datën 19.06.2024 ka publikuar B58 Njoftimin mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues ku ka shpërblyer me kontratë “Tomato Sh.p.k.

Ky aktivitet i prokurimit është zhvilluar me procedurë të hapur me llojin e kontratës: shërbim, vlera e parashikuar e kontratës: 30,000.00 euro.

Me 18.06.2024, OE Donjeta Gashi Hamzaj B.I., ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër vendimit të lartcekur të AK. Më 19.06.2024 Autoriteti Kontraktues ka refuzuar kërkesën për rishqyrtim.

Me 01.07.2024, OSHP ka pranuar ankesën nga OE Donjeta Gashi Hamzaj B.I., me numër protokollit 580/24 lidhur me aktivitetin e prokurimit “Fushatë vetëdijesuese për riorganizimin e Arsimit në Kryeqytet” me nr. të prokurimit: "616-24-4754-2-2-1".

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

Paneli Shqyrtues ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues Donjeta Gashi Hamzaj B.I., janë parashtruar si në vijim:

Pretendimet e Operatorit Ekonomik : Për çështjen e çmimit, oferta jonë ishte në përputhje me kriteret për tenderin, duke mos e vlerësuar çmimin si jo normalisht të ulët. Autoriteti Kontraktues (AK) nuk ka ndjekur procedurat për trajtimin e ofertave të tilla sipas rregullores së aplikueshme dhe nuk ka kërkuar sqarime përpara eliminimit. Në lidhje me dëshmitë e kërkuara për qarkullim financiar, kemi paraqitur dëshmi të mjaftueshme për tregimin e këtij qarkullimi, edhe pse nuk janë dorëzuar të gjitha dokumentet e kërkuara. AK duhej të kishte kërkuar sqarime për këtë përpara vendimit të eliminimit. Për çështjen e listës së pajisjeve, kriteret specifike nuk ishin të

qarta dhe AK nuk kishte kërkuar informacione shtesë për të siguruar që këto kritere të plotësoheshin. Ne kishim paraqitur informacion të detajuar për pajisjet në ofertën tonë. Në lidhje me listën e stafit, kemi dorëzuar informacionin e kërkuar në dokumentacionin teknik, megjithatë AK konstaton se ky informacion mungon. Kemi siguruar CV-të për secilin person në listën e stafit. Kërkojmë që AK të rishqyrtojë vendimin dhe të konsiderojë argumentet tona përparësore për të garantuar zbatimin e ligjit dhe drejtësinë në procesin e prokurimit

Përgjigje e AK në kërkesën për rishqyrtim: Autoriteti Kontraktues është përgjigjur në pretendimet ankimore të operatorit ekonomik në lidhje me eliminimin e tyre nga procesi i prokurimit. Sipas letrës së standarde të dërguar, operatori ekonomik u shpall "i papërgjegjshëm" dhe u eliminua për arsye të specifikuara: çmimi jonormalisht i ulët, mungesa e deklaratave tatimore dhe dokumentacionit për qarkullimin financiar, si dhe mungesa e listës së pajisjeve dhe e listës së stafit. Autoriteti Kontraktues ka theksuar se nuk është përgjegjësia e tyre të përmisojë ose të korrigjojë gabimet e tenderuesve pas hapjes së ofertave. Në bazë të argumenteve dhe dokumentacionit të paraqitur, Autoriteti Kontraktues ka refuzuar rishqyrtimin e vendimit të eliminimit dhe vendimi për eliminimin e operatorit ekonomik është mbetur në fuqi.

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Organi Shqyrtues i prokurimit me datë 08.07.2024 ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 580/2024, ndërsa me datë 08.07.2024 është dorëzuar raporti i ekspertit shqyrtues me nr. 2024/0580 me rekomandimet si në vijim: “Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar, të anulohet njoftimi për kontratë dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim”.

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. AK nuk është përgjigjur lidhur me rekomandimin e raportit të ekspertit shqyrtues, ndërsa OE është pajtuar lidhur me mendimin e ekspertit.

Paneli shqyrtues ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet për të vendosur mbi këtë lëndë pa seancë dëgjimore në kuptim të nenit 24 paragrafi 1 të Rregullores së Punës së OSHP-së duke marr parasysh që pretendimet e palëve dhe parashtresat e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritore lidhur me rastin.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave –

Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova raportin e ekspertit, mendimet e palëve lidhur me raportin e ekspertit, parashtresat dhe dokumentet e ankuesit, shkresat dhe dokumentet e autoritetit kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Lidhur me pretendimet e OE Donjeta Gashi Hamzaj B.I., eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2024/580 ka vlerësuar si në vijim:

Autoriteti Kontraktues, i cili është Komuna e Prishtinës, është përballur me disa pretendime nga Operatori Ekonomik (OE) Donjeta Gashi Hamzaj B.I. në lidhje me procedurat e tenderimit dhe vlerësimit të ofertave. Këtu janë pretendimet dhe veprimet që duhet të ndërmerret Autoriteti Kontraktues sipas rregullave të aplikueshme:

Pretendimi për çmimet abnormalisht të ulëta: Rregullat parashikojnë se një tender mund të konsiderohet "abnormalisht i ulët" dhe për këtë duhet një hetim i detajuar nga Autoriteti Kontraktues. Autoriteti duhet të kërkojë një shpjegim të detajuar nga OE për shkaqet e çmimeve të ulëta të ofruara. Autoriteti Kontraktues ka të drejtë të refuzojë tenderin. Pretendimi për gjendjen ekonomike dhe financiare: Autoriteti Kontraktues mund të kërkojë sqarime shtesë nga OE për të vlerësuar gjendjen e tyre ekonomike dhe financiare, sipas nenit 72 të Ligjit për Prokurim Publik. Kjo është një kërkesë e rregullt për të siguruar që OE ka kapacitetin për të kryer kontratën në mënyrë të suksesshme. Pretendimi për listën e pajisjeve dhe personelit: Eksperti Shqyrtues ka konstatuar se listat e pajisjeve dhe personelit të OE janë të plotësuar sipas kërkesave të tenderit. Kjo përcakton që OE ka plotësuar këtë kërkesë teknike në mënyrë adekuate për ofertën e tyre. Arsye e refuzimit të kërkesës për rishqyrtim: Autoriteti Kontraktues ka argumentuar se OE nuk ka plotësuar kërkesat për dokumentacionin e nevojshëm për njoftimin e kontratës. Kjo arsye është e vlefshme për refuzimin e kërkesës së OE për rishqyrtim. Për të vlerësuar çdo pretendim të OE Donjeta Gashi Hamzaj B.I., Autoriteti Kontraktues duhet të sigurojë se çdo veprim është në përputhje me ligjin dhe rregulloret për prokurimin publik. Është e rëndësishme që çdo vendim të jetë i argumentuar dhe dokumentuar mirë për të shmangur ankesat dhe kontestimet e mundshme në procesin e tenderimit.

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues –

Paneli shqyrtues në mënyrë të pavarur dhe objektive, me ndërgjegje dhe kujdes profesional ka vlerësuar të gjitha provat e rastit. Në këtë mënyrë është gjetur se Autoriteti Kontraktues nuk ka vepruar në përputhje me dispozitat ligjore për prokurimin publik dhe kërkesat e dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin "Fushatë vetëdijesuese për riorganizimin e Arsimit në Kryeqytet" me nr. të prokurimit: "616-24-4754-2-2-1". Paneli shqyrtues vlerëson se eksperti shqyrtues i ka trajtuar në mënyrë profesionale dhe objektive pretendimet e operatorit ekonomik ankues Donjeta Gashi Hamzaj B.I., dhe se Argumentimi në raportin e ekspertit është mjaft i detajuar, i kuptueshëm dhe i bazuar tërësisht në dokumentet relevante që i referohen aktivitetit të prokurimit. Konstatimet në raportin e ekspertit mund të konfirmohen përmes dosjes së tenderit si dhe dokumenteve me të cilat kanë ofertuar tenderuesit. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankues i ka falur besimin e plotë raportit të ekspertit. Në këtë mënyrë është gjetur se pretendimet e operatorit ekonomik ankues Donjeta Gashi Hamzaj B.I., janë të bazuara.

Paneli shqyrtues pas administrimit dhe vlerësimit të provave, konstatimit të plotë të gjendjes faktike, duke u mbështetur në LPP si ligj material të zbatueshëm, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe rekomandimet e

ekspertit shqyrtues, ka gjetur se ankesa e Operatorit Ekonomik aprovohet si e bazuar. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues ka vendosur lidhur me aktivitetin e prokurimit me "Fushatë vetëdijesuese për riorganizimin e Arsimit në Kryeqytet" me nr. të prokurimit: "616-24-4754-2-2-1", të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe lënda të kthehet në rivlerësim.

Panelit Shqyrtues ka vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës. Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Për pikën I të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 117 të LPP lidhur me nenin 29 dhe 31 paragrafin të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën II të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 131 të LPP lidhur me nenin 29 paragrafin 3 të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën IV të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 31 paragrafin 4 dhe paragrafin 6 të Rregullores së Punës së OSHP lidhur me nenin 118 të LPP.

Andaj nga të lartcekurat, paneli shqyrtues në pajtim me nenin 117 të LPP-së vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

Batisha Ibrahim

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur ka të drejtë që ti drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, Dhoma e shkallës së parë-Departamentit për çështje Administrative, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES**
- **OE - Donjeta Gashi Hamzaj B.I.**
- Arkivës së OSHP-së: